

MATERIALE SHKENCORE E KUMTESA

VASILJANO BUBA

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

vasiljano97@gmail.com

FILANTROPIA ORTODOKSE DHE KONTRIBUTI I SAJ NË QYTETIN E KORÇËS (SHEK. XVIII-XIX)*

Abstrakt:

Ndonëse qyteti i Korçës u zhvillua paralelisht me vendosjen e sundimit osman në gadishullin e Ballkanit, nuk mund të mendohet ky kultivim dhe shndërrimi si një zhvillimi që mori për gjithë zonën, nëse nuk do të ishte vokacioni shpirtëror dhe largpamësia e shoqërisë korçare. Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë te lexuesi një pasqyrë sa më të qartë se si edukimi dhe fryma ortodokse e qytetit të Korçës ka luajtur një rol fundamental në urbanizimin e këtij qyteti.

Është me mjaft interes evidentimi, se si vektorizimi religjioz, në rastin e komunitetit të krishterë ortodoks, Mitropolia e Korçës ndikonte tek të gjitha sferat e shoqërisë, duke organizuar një ripërtëritje të tyre e duke emancipuar të gjitha segmentet e jetës. Kësisoj, përveç dimensionit fetar, Mitropolia shërbente edhe si një rregullator i aktiviteteve jo vetëm shpirtërore, por edhe ekonomike, krahas atyre kulturore. Produkti që u përfitua ishte pikërisht një qytet që rezononte një valencë humane, ekonomike dhe urbanistike tejet të avancuar për kohën, duke u kthyer në një simbol të sinergjisë mes komunitetit fetar e filantropisë.

Fjalë kyçe:

Histori sociale, filantropi, Mitropoli e Korçës, aktivitet ekonomik, urbanizim i vektorizuar, rëndësi kulturore, bamirës të mëdhenj.

* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore me temë: "Kërkimi shkencor dhe edukimi në perspektivën e studentëve dhe studiuesve të rinj. UT flet me zërin e studentëve", Tiranë, më 18-19 maj 2023.

Korniza historike

Qyteti i Korçës për herë të parë dokumentohet në dorëshkrimin e Gjon (Joan) Muzakës, “*Historia dhe gjenealogjia e Derës së Muzakajve*” që e përmend Korçën si një kështjellë, e cila ekzistonte aty nga fundi i shek. XIII. Pranë kështjellës ka qenë fshati Peshkëpi, i cili iu dha si feud Mirahorit nga Sulltan Bajaziti II. Korça pra mendohet se është produkt i shkrirjes së kështjellës me fshatin Peshkëpi.¹

Duke qenë se fokusi i temës sonë janë shek. XVIII-XIX, dhe për më tepër zhvillimet politike nuk janë në plan primar, do të abstraktojmë në shek. XVIII, me prioritet zhvillimet urbanistike por tangent do të prekim edhe derivate të jetës sociale, për të paraqitur një simetri sa më të plotë.

Dihet se Korça mori një hov të madh zhvillimi pas popullimit të saj prej banorëve të *Vithkuqit dhe Voskopojsë*² por jo vetëm, që u zhvendosën aty për shkak të pasigurive gjeopolitike të kohës. Gjithashtu mbas mesit të shek. XVIII, qyteti u rrit ndjeshëm, kjo pasi kishte konsoliduar pozitat e veta si qendër ekonomike dhe kulturore. Në këtë periudhë, siç e përmendëm edhe më lart, qyteti rritet në mënyrë eksponenciale duke diktuar kësisoj edhe një organizim urbanistik më të sofistikuar.

Nëse bëhet një retrospektivë, fillesat urbane sigurisht që do të ishin tejet modeste, konkretisht, sipas dokumenteve arkivore të *Kodikut të Korçës dhe Selasforit*,³ qyteti i Korçës gradualisht filloi të fitonte një peshë dhe rezonancë ekonomike në krahinën e saj, lidhur ngushtësisht kjo edhe me rëndësinë që mori qyteti si qendër administrative kishtarë ortodokse.⁴

¹ Andrea Llukani, *Mitropolia e Korçës* (Tiranë: 2020), 3.

² Eduart Caka, “Të dhëna mbi disa vakëfe kryesore të qytetit të Korçës gjatë periudhës osmane”, në *Studime historike*, nr. 1-2 (2017): 86-87.

³ Emri i Kodikut është: Κώδικς της Θεοσόστου και αγιότατης Μητροπόλεως Κορυτσάς και Σελασφόρου (Kódiks tis Theosóstou kai agiótatis Mitropóleos Koritsás kai Selasfórou / Kodiku i Mitropolisë së Perëndimbrojtur dhe fort të shenjtë të Korçës dhe Selasforit).

⁴ Petraq Pepo, *Kodiku i Korçës dhe i Selasforit. Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore të shek. XVIII - fillimi i shek. XX*, përgatiti për botim Aurel Plasari, Akademia e Studimeve Albanologjike, Qendra e Botimeve Enciklopedike (Tiranë: 2018), 11.

Rrjedhimisht, kjo nënkuptonte edhe nevojën për një riorganizim të ri. Sipas dokumenteve, dy prej qendrave ekonomike të kësaj treve që ishin *Vithkuqi*⁵ dhe *Voskopoja*,⁶ por edhe Korça që ishte në fazat embrionale të zhvillimit të saj, megjithëse ndodheshin në sulme periodike dhe kushte të vështira prej regjimit osman [më tepër prej abuzimeve në emër të pushtetit prej qeveritarëve lokalë, – V. B.], vazhduan progresin e tyre ekonomik, arsimor e kulturor.⁷

Aspekti ekonomik

Prej paraqitjes nga burimet e kodikëve të ndryshëm, qyteti i Korçës pas disa plaçkitjesh filloi të stabilizohet nga mesi i shek. XIX, kjo në kuadër edhe të tolerancës që reformat e sulltanit kishin reflektuar te gjendja social-ekonomike. Për sa i përket zhvillimit ekonomik, sipas kodikut të Korçës, evidentohen një sërë organizatash tregtare dhe zejtare, si: kasapët, opingarët, samarxhinjtë, bakërshinjtë etj.⁸

Pazari i Korçës kishte një diversitet të vërtetë produktesh, krahas produkteve bujqësore-blegtorale, aty tregtoheshin edhe prodhime zejtarie, si: enë balte, materiale ndërtimi dhe punime druri.⁹ Pazari mund të quhet relativisht i madh duke nisur nga fakti se gjatë zjarrit të vitit 1879 aty u dogjën tërësisht 600 dyqane, por ai u rindërtua përsëri nën mjeshtërinë e Naum Kotokos, ky i fundit këtë herë sipas dëshmimeve e ndërtoi më së shumti me gurë dhe hekura.¹⁰

Një tjetër fakt interesant është edhe përdorimi i një shumëllojshmërie monedhash, sigurisht nuk mungonin dhe ata që në gjuhën

⁵ *Po aty*, 303; Dhori Koti, *Monografi për Vithkuqin dhe Naum Veqilharxhin* (Elbasan: Sejko, 1998), 30.

⁶ Joan Pelushi, “Kodiku i manastirit të Shën Prodhromit”, në *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i Iluminizmit në Ballkan*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Tiranë: 2019), 355; Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës 1669-1769*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Tiranë: Toena, 2010), 199, citon F. Pouqueville, *Voyage dans la Grèce*, vëll. II (Paris: 1821), 392-393; Stilian Adhami, *Voskopoja* (Tiranë: 8 nëntori, 1989), 172-173, citon “Bibliotekat tona”, në *Ylli*, nr. 7 (1976), 92; *po aty* citon: P. Papahagi, *Scrītorī arōmani* (Bukuresht: 1909), 21; Papa Kristo Negovani, *Prishja e Hormovës* (Tiranë: Naim Frashëri, 1960), 103; Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare (shek. XV-XX)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Tiranë: 1973), 199.

⁷ Pepo, *Kodiku i Korçës dhe i Selasforit*, 12.

⁸ *Po aty*, 23.

⁹ *Po aty*, 24.

¹⁰ *Po aty*.

popullore quheshin matrapazë, ose spekulatorët e sotëm që siguronin fitime të mëdha. Duhet përmendur fakti që esnafet e Korçës kishin një disiplinë në raport me çirakët dhe tregun. Një aspekt me karakter fetar, ishte fakti se, secili esnaf ose vihej “nën hijen” e shenjtorit mbrojtës, për shembull, kondakçinj të festonin Shën Athanasin, apo kremtonin një festë fetare; për ilustrim kasapët festonin me Ipapandinë (paraqitja e Zotit Jezu Krisht në Tempull 40 ditë pas Lindjes së Tij).¹¹

Ajo që i dha një impuls shumë të madh ekonomik qytetit ishte krijimi i “*Llasos*” * nga Mitropolia e Shenjtë e Korçës, me qëllim inkurajimin e zhvillimit të vendit dhe asistencën ekonomike për biznesin e vogël dhe të mesëm korçar. Kjo vinte si nevojë për t’i lehtësuar njerëzit nga kamatat e fajdexhinjve duke i shpëtuar kështu prej falimentimit, çka përbën një tjetër altruizëm utilitar, i cili e rendit tashmë edhe në formë të institucionalizuar, institucionin e Mitropolisë si bamirësen e parë më të madhe të qytetit.¹²

Në raport me vendet që kishin marrëdhënie tregtare me Korçën, mund të përmenden qytetet e Italisë, Austrisë, Hungarisë etj.¹³ Ky zhvillim pasqyrore një ekonomi të zhvilluar, dhe sipas Thimi Mitkos në pazarin e Korçës numëroheshin mbi 700 dyqane, e shtuna ishte dita e asaj që quhej pazari i madh nga ku vinin për të blerë që prej Kosturit deri në Prespë dhe Përmet.¹⁴ Madje, sipas studiuesit Zija Shkodra, përveç kufijve të qarkut që përfshinin 56 fshatra, vinin blerës edhe prej Selanikut (që me kushtet e kohës mendohet se ishte 48 orë larg) dhe Manastirit.¹⁵

¹¹ *Po aty*, 25.

* Quhej arka e përbashkët e kontribuesve dhe e besimtarëve, e pajisur edhe me një kanonizëm/statut; ajo përdorej për mbajtjen e institucioneve arsimore-kulturore, si dhe për ndihmën e vajzave të varfra në moshë martese.

¹² Dion Tushi, “Fizionomitë filantropike korçare dhe kontributi i tyre në krijimin e prototipave dhe karakterëve të denjë për t’u imituar”, gazeta *Korça*, nr. 177 (janar, 2011), 3.

¹³ Pepo, *Kodiku i Korçës dhe i Selasforit*, 27.

¹⁴ *Po aty*, 28, citon George Young, *Corps du droit ottoman*, vol II (Oxford: 1905-1907), 12, 13.

¹⁵ Zija Shkodra, *Qytetet Shqiptare të Rilindjes* (Tiranë: 8 Nëntori, 1990), 115, citon *Fjamuri i Arbërit*, nr. 9, (Corigliano Calabro: 1884), 10.

Urbanizimi si produkt i filantropisë

Nëse analizojmë sistemin urbanistik, së pari, duhet të theksojmë se një ndër ndërtesat e para të qytetit ishte xhamia e Ilias Bej Mirahorit, ky i fundit, sipas Nuçi Naçit, *këtu bleu një kishë me emrin “Shën e Premte”, të cilën e bëri së pari teqe, më pas xhami dhe kjo sot është Xhamia e Madhe*.¹⁶ Në kuadrin e institucionit të vakëfit, përveç godinave të kultit, u ndërtuan edhe institucione bamirësie, medrese, ura etj. Kjo do të ishte edhe bërthama e parë urbanistike e qytetit.

Prej pozicionit të vet gjeografik, Korça ishte shumë larg qendrës së asaj kohe dhe prej pushtetit nuk iniciohej asnjë përpjekje për zhvillimin urban të qytetit, aq më tepër për emancipimin apo përmirësimin e cilësisë së jetesës.

Në të tilla kushte qytetarët kuptuan që progresin e qytetit do të duhej ta bënin vetë; të paktën për pjesën ortodokse të tij, ku frymëzuesja dhe indikator kryesor ishte Mitropolia e Korçës. Në përgjithësi, të gjithë mitropolitët që kanë qenë, kanë kontribuar në zhvillimin e qytetit, duke frymëzuar me vetë shembullin e tyre formimin e ndjenjës bamirëse dhe *filantropike** për qytetin.¹⁷

Vlen të theksohet se mënyra e atëhershme e organizimit të komunitetit ortodoks me qendër administrative Mitropolinë e Shenjtë dhe *Dhimogjerondinë*¹⁸ afër saj, dha shembullin më të mirë në mirëmenaxhimin e shumave të dërguara prej emigrantëve, duke i dhënë prioritet jo vetëm arsimimit të fëmijëve në vend, por duke krijuar një infrastrukturë dinjitoze, duke tërhequr nëpërmjet pagave të larta profesorët më të mirë të rajonit, dhënies së bursave për në Perëndim për

¹⁶ G. Basha, *Historia e Korçës 520-vjeçare*, citon N. Naçi, “Korça dhe katundet e qarkut”, viti 1923, 57, <https://meganews.al/2021/11/03/historia-e-korces-520-vjecare/> (shikuar më 27.01.2022); shih edhe Arben Gjata, “Të dhëna dokumentare për mesjetën e qytetit të Korçës”, revista *Tempulli*, nr. 2 (2000), f. 46-52.

* *Filantropia*, vjen nga fjala greke *φιλανθρωπία*, etimologjikisht kupton “*αγάπη του ανθρώπου*” (agápi tou anthrópou / dashuri për njeriun).

¹⁷ Dion Tushi, *Filantropët dhe bamirësit e mëdhenj të qytetit të Korçës*, 10 qershor 2020, <https://www.youtube.com/watch?v=s9qzetRx1ko>. (Intervistë online te Radio Ngjallja).

¹⁸ Forumi mbikëqyrës i institucioneve të Mitropolisë, përbëhej prej kryetarit që ishte mitropolit, dhe prej 8 anëtarësh laikë. Për më shumë, shih statusin e këshillit: Pepo, *Kodiku i Korçës dhe i Selasforit*, 278-281.

përgatitjen e intelektualëve, ndërtimeve social-kulturore, si dhe urbanizimit të qytetit.¹⁹

Mitropolia kishte përvojën e duhur për menaxhimin e parave të dërguara por edhe mirëbesimin e besimtarëve, pasi këtë rol ajo e kishte kryer ndër vite, duke shërbyer në njëfarë mënyre si një institucion bashkiak me termat e sotëm. Duhet të kemi parasysh se fillesat e para të bamirësisë datojnë qysh prej fillimit të shek. XVIII, që korrespondojnë edhe me emigrime relativisht të konsiderueshme. Këtu bëhet fjalë për emigrantët korçarë të Egjiptit,²⁰ apo Misirit siç quheshin ndryshe.

Këta të fundit dhuronin shuma të konsiderueshme parash të cilat, siç e lartpërmendëm, ia besonin institucionit të Mitropolisë. Ndër investimet primare ishte krijimi i shkollave të para. Duhet thënë se Korça rezultoi si një nga të paktat qytete ku kishte shkolla për djem (e para më 1724),²¹ por edhe për vajza (1857),²² duke lënë të kuptohet që roli i emancipimit të gruas apo nënës kishte rëndësi për zhvillimin më të shëndetshëm të qytetit.

Përveç arsimit, një rëndësi e madhe iu dha edhe infrastrukturës urbane. Në këtë mënyrë Korça ishte qyteti që krijoi dhe zhvilloi një rrjet urbanistik të mirëpërcaktuar, kjo evidentohet sidomos te lagjet e reja.

Deri nga mesi i shek. XVIII, Korça ndahej në mes nga lumi që zbriste prej Moravës nga ku formoheshin 2 ngastra: te ngastra nga ana e djathtë që emërtohej “Varosh” (përballë kalasë), e cila ishte lagjja ku banonin të krishterët, shtëpitë zakonisht ishin dykatëshe, material guri, por kjo kryesisht diktohej nga gjendja ekonomike;²³ këtu ishin vetëm dy lagje, “Mitropolia” dhe lagjja “Penço”. Me zgjerimin e qytetit u formuan edhe lagje të tjera, ku kryesisht elementi ortodoks u përqendrua në atë që quhej “Katavarosh” (sot Shën Maria).

Në të majtë të lumit ishte ngastra që quhej “Kasaba” që banohej prej popullsisë myslimane, me ndërtime tipike orientale; material ndërtimi prej plithari përdorej në masë, sidomos prej të varfërve.²⁴ Në

¹⁹ Tushi, “Fizionomitë filantropike korçare”, 3.

²⁰ Artan Hoxha, *Një zhvillim historik mbi zhvillimin e filantropisë në Shqipëri* (Tiranë: 2011), 12, citon *AQSH*, F. 97, V. 1928, D. 22, fl. 1.

²¹ Pepo, *Kodiku i Korçës dhe i Selasforit*, dok. nr. 8, 88.

²² *Po aty*, dok. nr. 45, 127.

²³ *Po aty*, dok. nr. 40.

²⁴ *Po aty*.

këtë hapësirë ishin lagjet “Çarshi”, “Batak”, “Qoshk” dhe “Dere”.²⁵ Pas zgjerimit edhe më tej të qytetit, ky element u zgjerua në atë që sot quhet Radanec.

Karakteristikë në formimin e infrastrukturës së re ishte fakti se u la vend për rrugë të gjera, rrugë të cilat akoma edhe sot sfidojnë denjësisht vizionin e tyre, kur në periudhën që po analizojmë mjet transporti ishte vetëm karroca me kuaj; mund të imagjinojmë pra çfarë mendësie kishin këto personalitete, duke qenë tejet avangarde jo vetëm për qytetet shqiptare, por edhe ato ballkanike.²⁶

Krahas arkitekturës urbane u kryen kanalizimet dhe sistemi i kullimit. Evidentohet fakti se qyteti i Korçës ka filluar të furnizohet me ujë të pijshëm që prej vitit 1799, dhe kompletimi me furnizim për të gjithë qytetin u realizua më 1879 falë fisnikut Jovan Banka.²⁷

Ky i fundit krijoi edhe fondacionin “Banka”*, që jepte në mënyrë periodike bursa studimi për të gjithë nxënësit korçarë ose ata që kishin të paktën babanë nga Korça. Gjithashtu, ai paguante dhe prikën apo pajën e 10 vajzave në vit, 5 të krishtera dhe 5 myslimane, që vinin prej shtresave me të ardhura më të ulëta ekonomikisht duke u dhënë atyre mundësinë të krijonin familje.²⁸

Një aspekt shumë i rëndësishëm, ishte edhe parcelizimi i tokës në formë ortogonike, kjo nënkuptonte faktin që kushdo që vinte në qytet dhe blinte një hapësirë, duhej ta zhvillonte atë në bazë të disa rregullave të mirëpërcaktuara, të cilat ndiqeshin në mënyrë rigoroze prej Mitropolisë.²⁹

Në kuadrin e urbanistikës një filantrop shumë i rëndësishëm ishte edhe Anastas Avramidhi Lakçe, që quhej ndryshe edhe plaku milioner. Kontributi i tij në urbanistikën e qytetit është i paçmuar. Ai dha një shumë të madhe parash për të ndërtuar kishën e Shën Gjergjit që ishte shenjtori mbrojtës, por edhe simboli i qytetit. Kjo vepër madhështore ka

²⁵ Caka, “Të dhëna mbi disa vakëfe”, 87.

²⁶ Tushi, *Filantropët dhe Bamirësit*, 04:17. (Intervistë online)

²⁷ Pepo, *Kodiku i Korçës dhe i Selasforit*, dok. nr. 185, 292.

* Fondacioni “Banka” së bashku me fondacionin “Sina”, ishin nga më të dalluarit. Krahas veprave mirëbërëse, bursave dhe filantropisë në qytetin e Korçës, në saje të aktivitetit të tyre ekonomik, bamirësitë e tyre shtriheshin edhe jashtë kufijve të shtetit osman, dhe më konkretisht në Athinë, Vjenë etj., duke influencuar edhe në zhvillimin e këtyre qyteteve falë bujarisë së tyre.

²⁸ Tushi, *Filantropët dhe Bamirësit*, 17:22. (Intervistë online)

²⁹ *Po aty*, 05:06.

qenë krenaria e gjithë zonës, ndërtimi dhe rrezatimi i së cilës kristalizonte më së miri dedikimin e korçarëve fillimisht ndaj Zotit, por edhe qytetit.

Një tjetër vepër e çmuar në gjerdanin e ndërtesave të Korçës, falë bujarisë së tij, ishte edhe ndërtimi i farmacisë së qytetit në fillim të bulevardit “Shën Gjergj”. Jo vetëm që dhuroi këtë vepër kaq të nevojshme por duhet përmendur edhe fakti, se ilaçet për të varfrit e qytetit jepeshin falas pa dallim feje.³⁰

Gjithashtu në memorien kolektive të Korçës, ka mbetur edhe zemërgjerësia e mjekëve të qytetit që të paktën një herë në javë vizitonin falas të sëmurët me pamundësi ekonomike. Deviza e njohur e Lakçes se: “*fëmijët e mi, janë të varfërit dhe të uriturit e qytetit*”, tregon pikërisht formën më të lartë të dashurisë për njeriun, frymëzuar kjo pa dyshim nga Ungjilli.

Aq shumë u shenjua në Korçë emri i tij, sa në ditën e Shën Athanasit për nder të Lakçes bëhej pushim në shkollat e qytetit. Pas meshës, dhespoti së bashku me këshillin e Mitropolisë dhe nxënësit e shkollave në oborrin e kishës ku ndodhej kopshti, mbanin fjalime dhe këngë në nder të tij.³¹

Një dukuri që evidentohet në këtë qytet është fakti se me kalimin e kohës, falë zhvillimit të arsimit lokal, fillojnë të kthehen në qytet edhe studentët e parë të cilët kishin studiuar jashtë. Këta të fundit, fillojnë të japin kontributin e tyre në fushat respektive, por duke mos harruar edhe ata vetë për të ndihmuar fëmijë të tjerë të pamundur financiarisht për të studiuar; e njëjta sjellje e tyre sikurse e bamirësve paraardhës që vendosën këtë lloj standardi, pra duke e kthyer filantropinë në një formë filozofie.³²

Këto personalitete, së bashku me shumë të tjera që i gjejmë te kodikët e Mitropolisë, kjo e fundit i nderonte në një datë specifike, më 30 janar, ditën e Tre Hierarkëve të Mëdhenj (Των Αγίων Τριών Ιεραρχών, «*Shën Vasili i Madh, Shën Grigor Theologu, Shën Joan Gojarti*»), të cilët janë edhe simboli i arsimit në traditën e ortodoksisë, dhe në nder të tyre kremtohet me madhësi panagjirike kjo ditë.

Kësisoj në këtë datë, mitropoliti në Katedralen e qytetit “Burimi Jetëdhënës” kujtonte* të gjithë ata që kishin kontribuar për qytetin, por

³⁰ Nikollaq Zoi, *Një faqe historie* (Korçë: Kotti, 2000), 32.

³¹ *Po aty*, 33.

³² Tushi, *Filantropët dhe Bamirësit*, 06:20. (Intervistë online)

* Kjo traditë vazhdon edhe sot në qytetin e Korçës.

sidomos për arsimin në veçanti, pasi qytetaria korçare e kishte kuptuar që arsimit ishte shtylla themelore e kombit. Një arsim i zhvilluar derivonte një vend të qytetëruar dhe më të emancipuar, duke formuar pra një mentalitet më të lartë jo vetëm kulturor, por edhe ekonomik.

Një fakt tjetër shumë domethënës për qytetin e Korçës, dhe që tregon shkallën e civilizimit të këtij qyteti ishte edhe shoqëria “*Vëllazëria e Miqve të të Vobektëve*”. Kjo strukturë unike filantropike, ishte kristalizimi më perfekt i afilacionit të shpirtit bujar të korçarëve. Themi kështu, pasi për vitet që ajo funksionoi ndihmoi njerëz të varfër, të burgosur, mbajti mësues dhe ngriti disa shkolla dhe një kopsht, të gjitha këto pa asnjë dallim fetar,³³ një valencë e lartë kulturore kjo për kohën.

Gjithashtu një produkt i sinergjisë së përbashkët ishte edhe kulla e sahatit, kjo e fundit sipas marrëveshjes do të ndërtohej prej myslimanëve, ndërsa ortodoksët do të ndërtonin sahatin dhe kambanën, sikurse edhe ndodhi.³⁴

Bamirësit e mëdhenj të Korçës me shembujt praktikë të dashurisë e të dhembshurisë për atdheun e tyre, si dhe për njerëzit që jetonin dhe do të jetonin këtu, arritën para së gjithash të ruanin tharmin rigjenerues dhe shpresëdhënës aq të nevojshëm për konservimin e përhapjen e vlerave të pastra humaniste dhe qytetare.

Për sa u përket dy fizionomive të veçanta e të rëndësishme të filantropisë korçare, siç ishin Anastas Lakçe dhe Jovan Banka, kontributi i tyre spikat për vetë vlerat e veçanta dhe autoritetin autentik të veprave të tyre, elemente që nuk hasen në figurat e tjera të nderuara të mirëbërjes dhe kjo për dy arsye.

I referohemi profesor Tushit kur artikulon se: *së pari*, nëse çdokush jepte diçka, pra duke u kthyer në normë, por në njëfarë mënyre edhe tregues i civilizimit, ata nuk dhanë nga ajo që u tepronte, por ata dhanë gjithçka kishin, përfshi edhe veten e tyre, duke e konsideruar posedimin e vlerave materiale jo si privilegj, jo si mjet për t’i krijuar konformitet atyre apo familjarëve të tyre, pasi ata nuk krijuan as familje, por si përgjegjësi përpara njerëzve dhe Zotit.³⁵

Së dyti, ai argumenton se pasuria e tyre nuk ishte e krijuar në Korçë dhe ata shquheshin për transparencën dhe rrugën e ndershme të vënies së

³³ Pepo, *Kodiku i Korçës dhe i Selasforit*, dok. nr. 176, 282-283.

³⁴ *Po aty*, dok. nr. 178, 284.

³⁵ Tushi, “Fizionomitë filantropike korçare”, 3.

kapitalit. Ata nuk ushtruan absolutisht asnjë biznes apo sipërmarrje në Korçë, siç ndodh me bamirësit e tjerë, kryesisht me ata pas viteve '20 të shek. XX në qytetin e Korçës, këtu ata bënë vetëm vepra që denjësisht ishin filantropike.³⁶

Përfundime

Grupimet shoqërore qytetare korçare në fillimet e shek. XIX, të karakterizuara nga një shpirt pragmatist dhe dëshirë për një jetë më të civilizuar, synuan drejt një hapi të ndjeshëm cilësor të nivelit të tyre jetësor, dhe vektori udhëheqës për këtë metamorfozë të qytetit ishin institucionet fetare. Këto të fundit, duke frymëzuar altruizmin fetar, farkëtuan një model njeriu që u bë shembull jo vetëm në transformimin e komunitetit, por gjithë qytetit.

Pikërisht në këtë periudhë, kur Korça konsiderohej si një qytet i vogël i Perandorisë Osmane, në Turqinë europiane, ajo vuante para së gjithash konsekuencat negative që rridhnin prej një pushteti absolut të centralizuar, administrata e korruptuar dhe regresive e të cilit nuk të krijonte as iluzionin më të vogël se, gjërat mund të përmirësoheshin së brendshmi dhe për pasojë as dëshirat dhe as aspiratat e popullatës nuk mund të gjenin realizim qoftë edhe në një minimum të mundshëm, brenda politikave që ndiqeshin.³⁷

Nuk ka dyshim se qytetërimi i Korçës dhe urbanizimi i saj bazohej te filantropia dhe kontribuesit e saj. Në përgjithësi, çdo qytetar korçar në bazë të mundësive që ka pasur, ka qenë kontribues në zhvillimin e urbanizimin e qytetit. Kjo sikurse evidentohet, në korrelacion me komunitetin e krishterë, i cili, pa dyshim, ka qenë inspiruesi dhe inxhinieria lëvizëse e jetës kulturore, artistike dhe eventualisht urbane.

Kështu brez pas brezi mund të konkludojmë se, filantropia u trashëguua jo vetëm si një mjet thjesht bamirësie njerëzore, por si dashuri për të gjithë qytetin; e gjitha kjo në emër të dashurisë që religjioni frymëzon. Kjo ishte edhe arsyeja e formimit të një fizionomie të veçantë për qytetin e Korçës, një urbanistikë e avancuar, por edhe një nivel intelektual i admirueshëm për kohën.

Me një elegancë modeste, mendimi ynë e gjen veten te përkrahimi ekselent që studiuesi Dion Tushi artikulon duke thënë se:

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty.

“Ne njohim disa emra, por është e pamundur të njihen mirëbërjet dhe emrat e qindra korçarëve të cilët të shtyrë nga ndjenjat humaniste që frymëzonte në zemrat e tyre religjioni, kanë dashur të mbeten anonimë, duke i qëndruar konsequentë parimit të pastër biblik që: “as dora e majtë të mos e dijë atë që jep dora jote e djathtë”.

Nën një frymë të tillë janë edukuar breza të tërë korçarësh brenda dhe jashtë atdheut. Megjithatë nuk duhet harruar më kryesorja “Mirënjohja për atë që të bën mirë”, për ata që farkëtuan këtë shpirt fisnik. Shpesh natyra njerëzore e pa kultivuar është e prirur për të kundërtën. Jo gjithmonë këto figura janë kujtuar, janë promovuar dhe janë nderuar ashtu siç u takon. Ndoshta për faktin e thjeshtë se në universalitetin e misionit të tyre, ata kurrë nuk kanë përfaqësuar interesat e një grupimi, apo nuk janë shquar për militantizëm. Ata kanë qenë gjithëpërfshirës së pari në parimet e tyre dhe më pas në kontributet, pa u ndikuar nga përkatësitë fetare, politike apo etno-kulturore.

Për pasojë nuk kanë qenë të përshtatshëm për t’u manipuluar apo, për t’u glorifikuar nga grupime meskine të përkohëshme. Përkundrazi vlerat e kujtimeve që kanë lënë pas kanë shërbyer për të kuptuar të vërtetën nga shtirja, altruizmin nga interesi i ngushtë, demagogjinë nga kontributi i pastër. Mirënjohja për ta është gjëja më e pakët, pasi kështu do të quhemi vazhdues të vlerave të përhershme diakronike”.³⁸

Bibliografi:

Botime dokumentare:

Pepo, Petraq. *Kodiku i Korçës dhe i Selasforit* (Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore të shek. XVIII - fillimi i shek. XX). Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2018.

Literaturë historiografike:

Adhami, Stilian. *Voskopoja*. Tiranë: 8 Nëntori, 1989.

Koti, Dhori. *Monografi për Vithkuqin dhe Naum Veqilharxhin*. Elbasan: Sejko, 1998.

³⁸ Po aty.

- Hoxha, Artan. *Një zhvillim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri*. Tiranë: 2011.
- Llukani, Andrea. *Mitropolia e Korçës*. Tiranë: 2020.
- Negovani, Papa Kristo. *Prishja e Hormovës*. Tiranë: Naim Frashëri, 1960.
- Pelushi, Joan. “Kodiku i manastirit të Shën Prodhromit”. Në *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i Iluminizmit në Ballkan*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2019.
- Shkodra, Zija. *Esnafet Shqiptare (shek. XV-XX)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1973.
- Shkodra, Zija. *Qytetet Shqiptare të Rilindjes*. Tiranë: 8 Nëntori 1990.
- Xhufi, Pëllumb. *Shekulli i Voskopojës 1669-1769*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë: Toena, 2010.
- Zoi, Nikollaq. *Një faqe historie*. Korçë: Shtypshkronja Kotti, 2000.
- Caka, Eduart. “Të dhëna mbi disa vakëfe kryesore të qytetit të Korçës gjatë periudhës osmane”. Në revistën *Studime historike*, nr. 1-2, 2017.
- Gjata, Arben. “Të dhëna dokumentare për mesjetën e qytetit të Korçës”. Në revistën *Tempulli*, nr. 2, 2000.
- Tushi, Dion. “Fizionomitë filantropike korçare dhe kontributi i tyre në krijimin e prototipave dhe karakterëve të denjë për t’u imituar”. Në gazetën *Korça*, nr. 177, 2011.

Gazeta dhe intervista online:

- Basha, G. *Historia e Korçës 520-vjeçare* (shikuar më 27.01.2022).
<https://meganews.al/2021/11/03/historia-e-korces-520-vjecare/>.
- Tushi, Dion. *Filantropët dhe Bamirësit e mëdhenj të qytetit të Korçës*. (Intervistë online te Radio Ngjallja) (shikuar më 10 qershor 2020).
<https://www.youtube.com/watch?v=s9qzetRx1ko>.

VASILJANO BUBA

“Fan S. Noli” University, Korça
 vasiljano97@gmail.com

S u m m a r y

ORTHODOX PHILANTHROPY AND ITS CONTRIBUTION TO THE CITY OF KORÇA (XVIII-XIX)

The conception of our paper evidences the impact that the orthodox factor has played in the city of Korça. As can be clearly seen, the contribution of the

Mitropolis institution has played a key role in the cultural, economic and urban emancipation. In addition to the Christian community, other communities have also played their role in this aspect. Since our focus is only on the Orthodox community and its contribution, we have tried to present their achievements in the educational, social, economic and urban fields. The special feature of our articulation lies in the fact of the philanthropic spirit that built the city of Korça, was inspired by the religious dimension of the people. The institution of Metropolis undoubtedly had a primary role in the cultivation of this feeling. The latter was the moving engineering of the social-cultural life of the city. Product of the affiliation of the Orthodox community were some of the biggest philanthropists of Korça, leaving an indelible mark on the city and its cultural level.

